

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Të hënë mblidhet Këshilli i Sigurisë/ Bardhi: Shqiptarët nuk kanë nevojë për spektakël institucional, por për përgjigje. Begaj të jap llogari njëloj si Rama
ADRESA	https://dosja.al/politike/te-henen-mblidhet-keshilli-i-sigurise-bardhi-begaj-te-sqaroje-nese-kreu-i515974
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 11:23:44 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 11:09:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	9266d82de9a8148d43272d458e6cac883a0c2730237645b880263dd8b6fbeada
TEKSTI	0dff5970c0999d35055daf919c5d1451be5ec7244b111bacf8eb42db357ef5e7
PAMJA	5579ecc4ba1ec64b521774165f09a8cb192848998d89445558c2785acdecbbc95

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	c0589ed9452375eb48a2ca51ed90f27b9e3a7fca509136dbf8bd87028b51aade
E MËPARSHMJA	77535177ac4bfbeb0f4c8be2a82ab63ef4b5bc5a0fa0d700cdd2394fca9be97f
RRËNJA MERKLE	3f529bf32420afe1b21bc6d3b8138bcb5df45885bcaf02ba5967dcac0a879fe4
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/c0589ed9452375eb48a2ca51ed90f27b9e3a7fca509136dbf8bd87028b51aade

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES

14 ORE ME PARE

Tensione dhe braktisje salla në OKB/ Netanyahu sulmon Turqinë e Katarin, paralajmëron rënien e regjimit iranien. Mamdani: Përdori fjalimin e tij për të përsëritur gënjeshtër të pabaza

19 ORE ME PARE

Dita e 117-të e protestës/ Qytetarët zbrasin sërish në shesh, kërkohet dorëheqja e kryeministrit Rama: Ju erdhi fund!

22 ORE ME PARE

Vlora Hyseni sulmon Klodiana Lalën para GJKKO-së, gazetarja: Shantazh. AGSH: Të tërheqë deklaratat (REAGIMET)

22 ORE ME PARE

Skandali SHISH/ Vlora Hyseni vë në rrezik vendin për Ergys Agasin: Të gjithë radarët e shtetit i mbyll për ty

Politike

Të hënën mbledhet Këshilli i Sigurisë/ Bardhi: Shqiptarët nuk kanë nevojë për spektakël institucional, por për përgjegjësi. Begaj të jap llogari njëloj si Rama

Bardhi thotë ndër të tjera se gjatë dy viteve të fundit janë ngritur publikisht pretendime për mënyrën e funksionimit të SHISH dhe për marrëdhënie të pretenduara mes individëve të caktuar dhe strukturave të krimit të organizuar



25 Shtator 2026, 13:09
Nga E. D



Gazment Bardhi

editoriale

Eriseld Zeneli

Shqipëria, socializmi i Edi Ramës pa të majtën

Irena Begiraj

Kostot e jetesës edhe lajmi se ekonomia po ecën mirë

Në vëmendje

TIRANË- Kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Gazment Bardhi, ka reaguar pas lajmit se Bajram Begaj do të mbledhë të hënën Këshillin e Sigurimit Kombëtar, pas skandalit të ndodhur me SHISH. Me anë të një reagimi, Bardhi shpreh se shqiptarët nuk kanë nevojë për një spektakël institucional, por për përgjegjësi.

Ai i drejtohet Begajt edhe me pyetjen se mbi çfarë verifikimesh është mbështetur vendimi për dekretimin e Vlora Hysenit në krye të SHISH. Bardhi thotë ndër të tjera se gjatë dy viteve të fundit janë ngritur publikisht pretendime për mënyrën e funksionimit të SHISH dhe për marrëdhënie të pretenduara mes individëve të caktuar dhe strukturave të krimit të organizuar.

Reagimi i Bardhit:

NUK KA NEVOJË PËR SPEKTAKËL INSTITUCIONAL. SHQIPËRIA KA NEVOJË PËR PËRGJIGJE.

Pas zhvillimeve të rënda në Shërbimin Informativ të Shtetit dhe situatës së krijuar pas vendosjes së drejtores së këtij institucioni nën masën e arrestit, Presidenti i Republikës, Bajram Begaj, pritet të mbledhë Këshillin e Sigurimit Kombëtar javën e ardhshme. Por shqiptarët nuk kanë nevojë për një mbledhje formale dhe as për një shfaqje institucionale. Ata nuk kanë nevojë që të mbledhet Këshilli i Sigurimit të Gysit. Qytetarët kanë nevojë për përgjigje konkrete.

Pyetja e parë dhe më e rëndësishme që i drejtohet Bajram Begajt është e thjeshtë:

AKTUALITET 25 SHTATOR 2026, 12:08

"Të q*fsha motrën"/ Shefi i Policisë së Krujës shan qytetarin, ai zbret nga makina dhe e qëllon me shpullë (VIDEO)

POLITIKE 25 SHTATOR 2026, 10:13

BIRN: Zyrtarët e lartë dhe krimi i organizuar u bënë njësh në mbrojtje të Ergys Agasit



Bajram Begaj duhet t’u shpjegojë shqiptarëve, në mënyrë të plotë dhe transparente, se çfarë informacioni, verifikimesh dhe procedurash janë ndjekur përpara emërimit të saj në krye të një prej institucioneve më të rëndësishme të sigurisë kombëtare. Opozita kishte ngritur publikisht pikëpyetje dhe shqetësime lidhur me këtë emërim. Sot, pas zhvillimeve të fundit, këto pikëpyetje kërkojnë përgjigje të menjëhershme institucionale.

ÇFARË VERIFIKOI PRESIDENTI DHE ÇFARË NUK VERIFIKOI INSTITUCIONI I PRESIDENTIT PËRPARA DEKRETIMIT?

Kjo është një pyetje që nuk mund të anashkalohet. Po aq serioze janë pyetjet që lidhen me sigurinë e informacionit të klasifikuar, burimeve njerëzore dhe informacionit sensitiv që administron SHISH. Nëse ekziston apo ka ekzistuar një rezik që informacionet e këtij institucioni, identitetet e burimeve apo të informatorëve të jenë ekspozuar ndaj strukturave kriminale ose shërbimeve të vendeve jo mike, atëherë kemi përpara një çështje me pasoja potencialisht shumë të rënda për sigurinë kombëtare.

Por përgjegjësia e Presidentit nuk fillon sot.

Gjatë këtyre dy viteve janë ngritur publikisht pretendime dhe shqetësime serioze për mënyrën se si ka funksionuar SHISH dhe për marrëdhënie të pretenduara ndërmjet individëve të caktuar dhe strukturave të krimit të organizuar. Bajram Begaj duhet të sqarojë nëse këto shqetësime janë verifikuar ndonjëherë nga institucionet përgjegjëse dhe, nëse po, cilat kanë qenë përfundimet e këtyre verifikimeve.

Nuk i kërkojmë Presidentit të ndërhyjë në hetimet e SPAK-ut apo në vendimarrjen e gjykatave. I kërkojmë të japë llogari për përgjegjësitë e veta institucionale.

EDHE ÇËSHTJA E BLOKIMIT TË BETIMIT TË ANËTARIT TË GJYKATËS KUSHTETUESE PËR LLOGARI TË ERGYS AGASIT KËRKON TRANSPARENÇË.

Bajram Begaj duhet të shpjegojë publikisht arsyet dhe bazën institucionale të vonesës së betimit për më shumë se 47 ditë të z. Asim Vokshi dhe të sqarojë nëse kjo vonesë ka qenë pjesë e një procedure normale institucionale apo nëse ka pasur rrethana të tjera që duhet t’u bëhen të ditura qytetarëve. Pretendimet për ndërhyrje të grupeve kriminale apo ndikim të paligjshëm në përbërjen e Gjykatës Kushtetuese janë tepër serioze për t’u lënë në nivelin e deklaratave politike. Ato kërkojnë transparencë dhe verifikim nga organet kompetente.

Prandaj, Këshilli i Sigurimit Kombëtar nuk mund të përdoret si zëvendësim për llogaridhënien. Presidenti, njëjloj si Kryeministri, duhet të përgjigjet për vendimarrjen e tij. Duhet të shpjegojë çfarë verifikoi, çfarë dinte, çfarë nuk dinte dhe çfarë masash janë marrë për mbrojtjen e sigurisë kombëtare.

Shqiptarët nuk kanë nevojë për një President që shfaqet vetëm pasi kriza ka shpërthyer. Shqiptarët kanë nevojë për një President që merr përgjegjësi, jep llogari dhe garanton se institucionet e sigurisë së Republikës nuk përdoren për interesa politike apo kriminale. Prandaj, përpara çdo mbledhjeje formale të Këshillit të Sigurimit Kombëtar, Bajram Begaj duhet t’u japë shqiptarëve transparencën që meritojnë. Jo propagandë. Jo formalitet. Jo heshtje. Përgjegjësi dhe transparencë./**Dosja.al**

gazment bardhi

Sondazh

Poll

AKTUALITET 25 SHTATOR 2026, 07:44

"O Kriminel, o mafia" / Shqiptarët qëllojnë me vezë Edi Ramën në SHBA: E gjithë Shqipëria ty të urren

më të klikuarat

"O Kriminel, o mafia" / Shqiptarët qëllojnë me vezë Edi Ramën në SHBA: E gjithë Shqipëria ty të urren

Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, kryeministri Rama mban sot fjalimin e tij në hapje të debatit

A e fshehu telefonin Ilir Proda? Gazetari Ferhati: Në SPAK deklaroi se i ishte thyer

Plagosja e të riut në Lezhë/ Pagesa e riparimit të makinës bëhet "mollë sherri", kamerat e sigurisë zbardhin konfliktin! Autorët u larguan me makinë, babë e bir në kërkim (EMRAT)

insights

Rezarta Gagani
Përballë pallatit tim po ndërtohet një pallat

Auron Janku
Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

Ola Xama
Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen

Idriz Konjari
Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Moti

Powered by tomorrow

Politike

25 Shtator 2026, 12:20

Sulmi i Vlora Hysenit ndaj gazetares Lala/ Luarasi: Reagimi i ish-drejtueses së SHISH është i papranueshëm

Iris Luarasi TIRANË- Deputetja e Partisë Socialiste, Iris Luarasi, ka reaguar lidhur me reagimin e ish-drejtueses së SHISH-it ndaj gazetares...

"TIMAK Defence" dhe KAYO në qendër të denoncimit të PD: Thesari pagoi 8.6 mln lekë, si u lëshua fatura para procedurës?

Politike

25 Shtator 2026, 10:31

"Europa nuk ka arritur ta zbatojë" / Rama nga SHBA: Paqja kusht politik që zhvillimi ekonomik e bën të mundur

Politike

25 Shtator 2026, 10:25

BIRN: Zyrtarët e lartë dhe krimi i organizuar u bënë njësh në mbrojtje të Ergys Agasit

Politike

25 Shtator 2026, 10:13

Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, kryeministri Rama mban sot fjalimin e tij në hapje të debatit

Politike

25 Shtator 2026, 08:42

Politike

24 Shtator 2026, 22:30

Kurti në 3-vjetorin e sulmit në Banjskë: Radoiçiç duhet të përballet me drejtësinë në Kosovë për sulmin, drejtësia nuk do të ndalet

Albin Kurti Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se vendi nuk do të ndalet derisa përgjegjësit për sulmin në Banjskë...

Analiza: Çfarë strategjie mund ta ndjekë Qeveria e Kosovës për apelin në Hagë?

Politike

24 Shtator 2026, 18:10

BE: Keqardhje që Serbia s'ka ndërmarrë hapat e nevojshëm për sulmin në Banjskë

Politike

24 Shtator 2026, 17:39

Kryemadhi pas daljes nga GJKKO: Në dosjen e SPAK ka më shumë ka komunikime të miat me Ramën, sesa me Metën!

Politike


24 Shtator 2026, 17:18

Sulmi i Vlorë Hysenit ndaj gazetares Klodjana Lala, reagon Gazment Bardhi: Balta dhe shpifjet nuk zëvendësojnë transparencën

Politike

24 Shtator 2026, 15:32

MË SHUMË



"O Kriminel, o mafia"/ Shqiptarët qëllojnë me vezë Edi Ramën në SHBA: E gjithë Shqipëria ty të urren

 Shiko video te tjera



KTHEHU NE KRYE 

Dosja.al është një iniciativë gazetarësh të rinj dhe njerëzish të lirë, që nuk ndikohet nga interesa politike apo biznesi. Informimi i paanshëm, qëndrimi i pavarur dhe etika profesionale janë parimet tona. Ka media të majta, të djathta, ka media në shërbim të partive apo biznesit, por ka edhe të pavarura, që kanë zgjedhur rrugën më të vështirë, por më të ndershme dhe më të sigurtë për të qenë të besueshëm. Dosja.al do të jetë gjithmonë e pavarur, e vërtetë, në krah të interesit publik.

Telefon/Whatsapp: +355 68 2676 444
Email:

AKTUALITET

POLITIKE

EKONOMI

BOTA

SPORT

Drejtör: Enton Abilekaj

Kryeredaktor: Izmir Akulli

Gazetarë:

Esmeralda Doçi

Emanuela Dida

Elisa Karaj

Florian Stani

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.